



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 13 Datë 13.06.2018

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENJERGJI  
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “GJONI-AN” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të enjergjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, per paisjen me autorizim(miratim ne parim) të subjektit “GJONI-AN” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “GJONI-AN” SH.P.K. me administrator Z. Pashk PEPKOLAJ, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Serës**, degë e Lumit Drin i Zi për prodhim enjergjie elektrike në fshatin Gjonpepaj, Njësia Administrative Lekbibaj, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC TROPOJË do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes nr.1:  $X_1 - 44\ 10\ 135.861$ ;  $Y_1 - 46\ 84\ 672.145$ ;  $Z_1 - + 630\ m$

Koordinatat e veprës së marrjes nr.2:  $X_2 - 44\ 10\ 160.168$ ;  $Y_2 - 46\ 84\ 883.830$ ;  $Z_2 - + 629\ m$

Koordinatat e godinës së centralit:  $X - 44\ 12\ 031.295$ ;  $Y - 46\ 85\ 441.873$ ;  $Z - + 225\ m$

Koordinatat e pikes së shkarkimit :  $X - 44\ 12\ 031.295$ ;  $Y - 46\ 85\ 441.873$ ;  $Z - +225\ m$

Prurja mesatare e përroit:  $Q_1\ mes = 0.294\ m^3/sek$ ;  $Q_2\ mes = 0.294\ m^3/sek$

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:  $Q\ llog = 0.37\ m^3/sek$ ;

Prurja ekologjike:  $Q\ ekol = 0.04\ m^3/sek$ ;

Prurja që shkarkohet:  $Q = 0.37\ m^3/sek$ .

2- Autorizimi(miratimi ne parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim enjergjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3-Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

SEKRETAR  
Raimonda GURI



KRYETAR  
Çesk MILLJA

